



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:100027
Datë: 28.08.2023
Numri i dokumentit: 04621631

Rev.nr.151/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Milena Gjeriq dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: L. L. nga P., rr. “.”, p.n., dhe Z. Z. nga fshati R., Komuna e P., të cilët i përfaqëson L. L. nga P., sipas autorizimit, kundër të paditurave: Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar D. S. – G., sipas autorizimit, dhe Ndërmarrja Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve”, në P., rr. “...”, p.n., të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar Sh. D., sipas autorizimit, për anulimin e njoftimit dhe kompensim i honorarit, duke vendosur sipas revizionit të paditësve i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4009/2021, të datës 07.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 07.08.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i paditësve: L. L. nga P., rr. “...”, p.n., dhe Z. Z. nga fshati R., Komuna e P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4009/2021, të datës 07.12.2022.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.507/19, të datës 16.04.2021, është vendosur: I. Pjesërisht miratohet kërkesëpadia e paditësve L. L. dhe Z. Z., si e bazuar. II. Anulohet njoftimi i datës 19.03.2019 i Komisionit Komunal të Aksionarëve, për përzgjedhjen e katër anëtarëve të Bordit të Drejtorëve N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” Sh.A., në P.. III. Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë së paditësve me të cilën kanë kërkuar që të anulohet konkursi nr., dhe që të mbeten në fuqi vendimet e Komisionit Komunal të Aksionarëve të datës 31.10.2014 dhe 30.10.2017, dhe të obligohet e paditura e dytë Ndërmarrja Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve”, në P. rr. “...” p.n., në P., që në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi paditësve t’iu bëjë kompensimin e honorarit (rrogave) në shumën prej 36,960 € bruto, me kamatë ligjore prej 8 % duke filluar nga data 07.05.2019, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si e pabazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4009/2021, të datës 07.12.2022, është vendosur: I. Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Pejës, ndryshohet pika II, e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.507/19, i datës 16.04.2021, dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve L. L. nga P. dhe Z. Z. nga fshati R., Komuna e P., me të cilën kanë kërkuar anulimin e njoftimit të datës 19.03.2019, të Komisionit Komunal të Aksionarëve, për përzgjedhjen e katër anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” Sh.A., në P.. II. Refuzohet si e pathemeltë ankesa e paditësve L. L. nga P. dhe Z. Z. nga fshati R., Komuna e P., ndërsa pika III, e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.507/19, i datës 16.04.2021, që ka të bëjë me pjesën e refuzuar të kërkesëpadi së paditësve, është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësit kanë paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rishqyrtim dhe rivendosje, apo që ky aktgjykim të ndryshohet dhe të mbetet në fuqi pika II, e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, dhe të miratohet ankesa e paditësve si e bazuar duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësve edhe në pjesën refuzuese të saj.

E paditura nuk ka parashtruar përgjigje në revizionin e paditësve.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësve është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit më datë 07.05.2019, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurave, për anulimin e njoftimit dhe kompensimin e honorarit, duke kërkuar më saktësisht si në parashtrësë, për plotësim të padisë të datës 27.10.2020.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësve kundër të paditurave, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.507/19, të datës 16.04.2021, me të cilin ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsytim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata në shqyrtim kryesor ka administruar këto prova: dosjet e kandidatëve të përzgjedhur në bord dhe dosjet e dy paditësve, vendimi i Komunës së Pejës të datës 31.10.2014, vendimi për vazhdim të mandatit të datës 30.10.2017, konkursi i datës 15.11.2018, konkursi i datës 14.01.2019, procesverbali i datës 28.09.2018, njoftimi për bordin e drejtorëve NPL - stacioni i autobusëve i datës 19.03.2019, fotografitë e nxjerra nga rrjetet sociale (facebook) 8 foto të datës 15.05.2017, ankesën e paditësve të datës 25.03.2019 dhe 26.03.2019, formulari i ankesës i datës 25.03.2019, shkresa e drejtorisë për zhvillim ekonomik drejtuar paditësit L. L. me nr....., formulari për kërkesë - ankesë i datës 11.04.2019, lajmërimi i Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik drejtuar paditësit Z. Z.- ..., vendimi i komisionit komunal të aksioneve të NPL - stacioni i autobusëve SH.A., në P. nr. Protokollit ... i datës 16.03.2017. Gjithashtu ka shtuar se pas analizimit të thënieve dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse në këtë procedurë si dhe administrimit të provave materiale ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke e anuluar njoftimin e datës 19.03.2019 të Komisionit Komunal të Aksionarëve për përzgjedhjen e katër anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Lokale (NPL) “Stacioni i Autobusëve” Sh.A., në P., pasi që ka konstatuar se i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nenin 12] paragrafi 2 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës së Pejës nr. 01/2020 nenit 20 par.1.4 dhe 51 par.1.4 të tij. Lidhur me konkursin nr..... të datës 14.01.2019 ka shtuar se konkursi

është i ligjshëm sepse është hapur dhe publikuar në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Punës. Për sa i përket kërkesëpadisë së paditësve lidhur me kompensimin e honorarit të tyre në shumën prej 36,960 € dhe kamatës ligjore prej 8% nga data 07.05.2019, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar, për arsye se me rastin e emërimit të bordit të ri të drejtorëve me datën 19.03.2019 ka pushuar së vepruari vendimi i datës 30.10.2017, me të cilin ishte paraparë vazhdimi i punës së bordit të atëhershëm deri në zgjedhjen e bordit të ri.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 8 të Ligjit të Punës, nenit 5.2, dhe nenit 17 paragrafi 3 të Ligjit për Ndërmarrje Publike, nenit 12 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenit 20 paragrafi 1.4 dhe 51 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Pejës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësit dhe e paditura kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.4009/2021, të datës 07.12.2022, ka vendosur që ta aprovojë ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e atakuar, ta ndryshoj, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, ka vlerësuar se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes për sa i përket pikës I dhe II, të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palëve ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar në pikën I dhe II, të dispozitivit të tij, ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet në pikën I dhe II, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që i njëjti aktgjykim nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara, për shkak se aktgjykimet në strukturë dhe përmbajtje janë në përputhje me nenin 160 të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së dytë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për pathemelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore të palës së paditur janë të bazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Me nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, përcaktohet se: “ Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohen nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t’i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar ”.

Me nenin 16 paragrafi 1 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Bordi i Drejtorëve të një NP Lokale do të përbëhet nga pesë (5) drejtorë ”.

Me nenin 16 paragrafi 2 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Katër (4) drejtorë zgjidhen në një mbledhje të aksionarëve në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare; dhe secili ka mandat prej tri (3) viteve. Komisioni Komunal i Aksionarëve e përfaqëson komunën në këtë mbledhje dhe i ushtron të drejtat e votimit të komunës në përputhje me nenin 5.2 të këtij ligji. Drejtori tjetër është KE i NP-së i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të NP-së në përputhje me nenin 21 të këtij ligji ”.

Me nenin 17 paragrafi 3 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t’i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim: a) duhet të jetë person që ka integritet të njohur, duke marrë parasysh, ndër tjera, çfarëdo shkelje materiale të detyrave fiduciare që mund të ketë bërë ky person ndaj cilitdo person tjetër; b) duhet ose (i) të ketë së paku pesë (5) vite përvojë - së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit - në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim thesari, banka, konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së; ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së ”.

Me nenin 171 paragrafi 3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, përcaktohet se: “ Pavarësisht nga skadimi i mandatit të drejtorit, ai vazhdon me ushtrimin e detyrave të tij përderisa të zgjidhet pasardhësi, në mënyrë që veprimtaria e bordit të drejtorëve të vazhdojë pa pengesë ”.

Me nenin 8 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: “1. Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. 2. Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi ”.

Me nenin 80 paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.2 dhe paragrafi 2 të Ligjit të Punës përcaktohet se: “ 1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t’i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tillë që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose 1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna. 2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente”.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Ligjit të Punës, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe nga shqyrtimi i të gjitha provave dhe shkresave të lëndës edhe Gjykata Supreme e Kosovës, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e pabazuar. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka konstatuar dhe ka vendosur që kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e pabazuar si në dispozitiv të aktgjykimit. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se të gjitha procedurat e zhvilluara nga ana e të paditurës janë në përputhje me dispozitat e lartcekura, prandaj pretendimet e paditësve se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave ligjore nga neni 16 pika 2 dhe nenit 17.3, të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, dhe nenit 171.3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, janë tërësisht të pabaza. Paditësit vetëm i janë referuar dispozitave të lartcekura por me asnjë provë nuk kanë arritur të dokumentojnë se të njëjtat dispozita janë shkelur nga ana e të paditurës. Duhet të kemi parasysh faktin se me vendim nr.prot.... të datës 30.10.2017, Bordit të Drejtorëve të N.P.L “Stacioni i Autobusëve”, Sh.A., në P., të zgjedhur me vendimin e datës 31.10.2014, në të cilin bord bëjnë pjesë edhe paditësit, i është vazhduar puna deri në përzgjedhjen e bordit të ri, dhe se me zgjedhjen e bordit të ri të gjitha kompetencat e bordit paraprak janë pushuar, dhe se përderisa nuk mund të vërtetohet se kemi të bëjmë me shkelje në procedurat e konkursit, për përzgjedhjen e bordit të ri nuk mund të pranohet kërkesëpadia e paditësve si e bazuar.

Në raport me pretendimet sa i përket kompensimit të honorarit, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe e dytë, drejtë kanë vendosur kur e kanë refuzuar një kërkesë të tillë, për faktin se me përzgjedhjen e bordit të ri, paditësit janë pa mandatë dhe rrjedhimisht nuk i takon një kompensim i tillë, ndërsa për pjesën sa kanë qenë me mandat të njëjtit janë kompensuar ashtu siç ka qenë e rregulluar me vendim.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.151/23, datë 07.08.2023

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi